

# #INNO4EDU

## Titulli i aktivitetit

Kopsht në shtëpi

## Mosha

Periudha zhvillimore (nga mosha 4 deri në 10 vjeçe)

## Hapësira / lokacioni

Kushte shtëpie

## Vlera e karakterit

Qëndrueshmëri

## Koha e nevojshme për përgatitje

10 minuta

## Koha e nevojshme për realizim

20-25 minuta

## Qëllimet

Qëllimi është që tek fëmija të zhvillohet kërsëria për botën bimore dhe kushtet për jetë.

## Rezultatet e pritshme

Fëmija në mënyrë të pavarur kujdeset për bimët dhe i dallon fazat e rritës.

## Kahje

### Përgatitje paraprake për aktivitet

Bashkë me fëmijën krijohen disa bimë (kopsht) nga pjesë të bimëve, të cilat zakonisht nuk përdoren dhe hidhen si mbeturina.

Fëmija do të kuptojë se disa fruta janë të përtëritshëm, gjegjësisht mund sërish të mbillen pjesë prej tyre dhe të përftohen pemë të reja, të cilat mëtutje do të përdoren si ushqim. Të gjitha perimet ose frutat që janë në shtëpi dhe materialet duhet të vendosen në tavolinë. Bashkë me fëmijët shikojeni videon që është dhënë në shtesë.

### Instrukcione/kahje për lojën


Me fëmijën bisedohet për llojet e ndryshme të pemëve dhe perimeve, ku dhe si rriten frutat, gjegjësisht si kultivohen. Pastaj i shpjegohet se disa fruta perimorë mund të përtërihen, me mbjelljen e disa pjesëve të tyre ( të cilat zakonisht nuk i përdorim në



ushqim).

### **Aktivitet/lojë**

- Fëmijës i tregohen pjesët e frutave perimorë, të cilat dotë mbillen dhe tërë perimet (ose imazh i perimeve nëse për momentin nuk janë të qasshme). Pastaj bisedohet për mundësinë nga pjesët përsëri të përftohen fruta të rinj.
- Lejojani fëmijës të mbjell disa fidanë siç është përshkruar më poshtë , të përkujdeset për to dhe ta ndjek procesin çdo ditë.
- Marule: vëreni rrënjën e marules në një enë me pak ujë. Në afat prej 3 deri në 5 ditë duhet të fillojnë të zhvillohen rrënjë dhe bima mund të kalohe në mugullishtë ose në tokë.
- Selino: vëreni pjesën e poshtme të selinos në ujë të ngrohtë (mbajeni nivelin e ujit çdo ditë dhe vëreni në dritë të drejtpërdrejtë dielli, përafërsisht një javë. Gjethet duhet të fillojnë të rriten gjatë javës dhe bima mund të kalohe në mugullishtë ose në tokë.
- Patate: vëreni lëvoret e thata të patateve thellë në tokë, afërsisht 10 centimetra. Fruti duhet të shfaqet në afat prej disa javësh.
- Ananasi: prijeni pjesën e sipërme të ananasit dhe vëreni në kruese dhëmbësh.
- Vëreni në një enë me ujë me majen fill mbi ujë (vetëm sa ta prek ujin, jo të jetë brenda në ujë). Ndërrojeni ujin në çdo të dytën ditë, ndërkaq dhoma duhet të jetë me temperaturë konstante dhe ena të jetë drejtpërdrejt nën dritën e diellit. Për përafërsisht një javë deri në dhjetë ditë, pasi të fillojë rrita, vëreni në tokë.

Shtesa	Materiale
<p><b>Shtesa nr. 1</b></p> <p>Link i videos nga punimi</p> 	<ul style="list-style-type: none"><li>• Marule (rrënja);</li><li>• Ananas (pjesa e sipërme);</li><li>• Karotë (pjesa e sipërme);</li><li>• Selino (pjesa e poshtme);</li><li>• Patate (lëvore);</li><li>• Disa vazo të vogla /mugullore/ ambalazh plastike;</li><li>• Dhe / tokë;</li><li>• Disa pjata me ujë;</li><li>• Bimë të tjera sipas dëshirës.</li></ul>
<b>Aktiviteti është përgatitur nga:</b>	
Edukatorë: Sonja Çallovska, Vesna Peceva	
Dizajn grafik: Katerina Nikolovska	
Lekturë: Jana Mihajlovska	
Përkthim: Agim Leka	

